



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsman Institution

Nr./Br./No. 2495/2018  
Nr.i fui/Br.str./Nr.pg. 23/11/18  
Data/Datum/Date:



Republika e Kosovës • République Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsman Institution

## RAPORT ME REKOMANDIME

A.nr. 493/2018

Esat Beqiri  
kundër

Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë  
dhe  
Shërbimit Korrektues të Kosovës

Për: Z. Abelard Tahiri, Ministër  
Ministria e Drejtësisë

Z. Shyqiri Bytyqi, Ministër  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë

Z. Nehat Thaçi, Drejtor  
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Heset Loku, Drejtor  
Qendra Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan

Kopje për: Z. Ismajl Kurteshi, Kryetar  
Komisioni Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini,  
Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Prishtinë, më 23 nëntor 2018

## Qëllimi i reportit

1. Qëllimi kryesor i reportit është tërheqja e vëmendjes së autoritetave kompetente të Republikës së Kosovës për respektimin e të drejtave të personave të dënuar për arsimim dhe edukim në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe standartet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

### Baza kushtetuese dhe ligjore

2. Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm *Kushtetuta*): “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”.

3. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, par. 4, “*Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime (...) me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoritetave janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut*”.

4. Gjithashtu, neni 18, par. 1 i Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjera, ka edhe këto përgjegjësi:

- “Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoritetave përkatëse në lidhje me rastet e tillë” (pika 2);
  - “të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (pika 5);
  - “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (pika 6);
  - “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës” (pika 7);
  - “të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (pika 8);
  - “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standartet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (pika 9).
5. Me dërgimin e këtij rapporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

## Faktet e rastit

6. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 5 korrik 2018, ka pranuar ankesën e z. Esat Beqiri kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK), i cili ankohet në emër të të birit të tij V. B., që është duke vuajtur dënimin me burgim në Qendrën Korrektuese në Lipjan (në tekstin e mëtejmë “QKL”), për shkak të pamundësisë për të vazhduar studimet universitare.
7. Më 10 korrik 2018, përmes postës zyrtare elektronike, Avokati i Popullit ka kërkuar nga drejtoria e QKL-së të njoftohet lidhur me gjendjen bazuar në pretendimet e ankuesit të paraqitura në ankesë.
8. Më 10 korrik 2018, përmes postës zyrtare elektronike, drejtoria e QKL-së e ka njoftuar Avokatin e Popullit si në vijim: *“I mituri V.B. gjendet në QK. Lipjan që nga data 07/12/2016, ku edhe e ka mbaruar arsimin e mesém të lartë. Sa i përket arsimit universitar sipas nenit 83 dhe 84 të LESP, MASHT dhe MD kanë nxjerr udhëzimin administrativ për arsimin e mesém por jo edhe për arsimin Universitar.”*
9. Më 18 korrik 2018, parashtruesi i ankesës përmes postës elektronike ia ka dërguar Avokatit të Popullit dokumentet relevante lidhur me ankesën e tij. Përveç kësaj, ankuesi e ka dërguar edhe raportin mjekësor të Departamentit të Shëndetësisë në Burgje (në tekstin e mëtejmë “DSHB”) duke pretenduar se të birit të tij nuk po i ofrohen shërbimet e duhura mjekësore në pajtim me problemin shëndetësor që e ka.
10. Më 19 korrik 2018, Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejmë “MKPT”) e vizitoi QKL-në dhe ankesën në fjalë e diskutoi me drejtorinë e këtij institucioni. Për më shumë, MKPT-ja e analizoi dosjen administrative të të dënuarit në fjalë. MKPT-ja u njofua nga drejtoria e QKL-së se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (në tekstin e mëtejmë “MASHT”), ende nuk e ka miratuar ndonjë udhëzim administrativ me të cilin do të precizohej çështja e arsimimit universitar për të dënuarit.
11. Më 24 korrik 2018, Avokati i Popullit ka kërkuar nga DSHB-ja të njoftohet me gjendjen shëndetësore të të dënuarit V. B. Në po të njëjtën ditë, më 24 korrik 2018, DSHB-ja ia ka dërguar Avokatit të Popullit raportin lidhur me gjendjen shëndetësore të të dënuarit V. B. dhe trajtimin shëndetësor që ofrohet në QKL. Përmes këtij rapporti, Avokati i Popullit, ndër të tjera, ishte njofuar se trajtimi shëndetësor i të dënuarit ishte bërë vazhdimisht sipas rekondimeve të Klinikës Hematologjike. Po ashtu, nga DSHB-ja janë paguar edhe analizat laboratorike të këruara nga kjo klinikë, të cilat nuk kryhen në Kosovë dhe janë dërguar në Francë. Përveç kësaj, DSHB-ja e njoftoi Avokatin e Popullit se nuk ka asnjë kërkesë nga Klinika Hematologjike për ndonjë shërbim të cilin nuk mund ta kryejë DSHB-ja.
12. Më 27 korrik 2018, MKPT-ja sërisht e vizitoi QKL-në me qëllim të trajtimit të ankesës në fjalë. MKPT-ja e intervistoi të dënuarin V. B., i cili u ankua lidhur me trajtimin e ofruar shëndetësor dhe pamundësinë për të vijuar edukimin universitar. Nga drejtoria e MKPT-së u siguruan kopjet e dosjes administrative, si dhe u analizua në hollësi dosja mjekësore e të dënuarit në fjalë.

13. Nga analiza e dosjes së tij mjekësore del se DSHB-ja ka siguruar të gjitha shërbimet e duhura mjekësore bazuar në natyrën e problemit shëndetësor dhe në rekomandimet e Klinikës Hematologjike.

14. Gjatë kësaj vizite, MKPT-ja ka pranuar ankesë edhe nga një e dënuar tjetër e mitur F. C., për pamundësinë për të vijuar arsimimin universitar.

#### **E drejta për arsimim e të miturit të privuar nga liria si e drejtë themelore e tyre – standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni i Republikës së Kosovës**

15. Avokati i Popullit, qysh në fillim rikujton se arsimimi i të miturve dhe madhorëve, të cilët janë të dënuar dhe qëndrojnë në institucionet korrektuese, është një nga detyrimi kryesore të institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës që buron nga Kushtetuta, ligjet në fuqi dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare. Si i tillë, ky detyrim i institucioneve për të realizuar një nga të drejtat themelore të njeriut, siç është ofrimi i mundësisë për arsimim për të rinjtë, nuk mund të shmanget as për të miturit që qëndrojnë në qendrat korrektuese, si në rastin konkret QKL-ja. Për me tepër, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se kjo e drejtë për të dënuarit duhet të mundësohet në kuadër të QKL-së, ose edhe jashtë institucionit, përkatësisht në shkollat e rregullta publike.

16. Aktet ndërkombëtare në nivel të OKB-së dhe ato në nivel evropian, që rregullojnë të drejtat për personat e dënuar, krijimin e mundësisë për arsimim e përcaktojnë si obligim i shtetit dhe në mënyrë të veçantë për të rinjtë që janë të privuar nga liria.

17. E drejta e të gjithë njerëzve për arsimim është mishëruar në nenin 26, paragrafi 1 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut<sup>1</sup>: “*Gjithkush gjzon të drejtën e shkollimit...*”. Kurse në paragafin 2 të kësaj deklarate përcaktohet se: “*Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai duhet të nxisë kuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes*”.

18. Në këtë drejtim, “Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria”, të miratuar në vitin 1990 (Rregullat),<sup>2</sup> përcaktojnë se: “*Çdo i mitur i moshës së detyrueshme për shkollim ka të drejtë për arsim të përshtatshëm për nevojat dhe aftësitë dhe të përcaktuara për përgatitjen e tij apo të saj për kthim në shoqëri. Kurdo që është e mundur, arsimi i tillë duhet të sigurohet jashtë objekteve të privimit nga liria, në shkollat e bashkësisë dhe, në çdo rast, me arsimtarë të kualifikuar përmes programeve të integruara në sistemin arsimor të vendit ashtu që pas lirimit, të miturit të minden që pa pengesë të vazhdojnë arsimin e tyre...*”(neni 38).

19. Në të njëjtën frysë janë edhe “Rregullat Evropiane të Burgut”, që janë miratuar nga Komiteti i Ministrave të KE-së, në vitin 2006 (RrEB), të cilat i kushtojnë një vëmendje të posaçme të drejtës në arsimim, duke përcaktuar se: “*Çdo burg duhet t'u japë të gjithë të burgosurve të drejtën për të marrë pjesë në programe edukative, të cilat janë të kuptueshme*

<sup>1</sup> Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, në:

[https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR\\_Translations/aln.pdf](https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf), (15.8.2018)

<sup>2</sup> Shih <http://www.un.org/documents/ga/res/45/a45r113.htm>.

*dhe plotësojnë nevojat individuale duke marrë parasysh aspiratat e tyre.”* (28.1); si dhe përcaktimi se: “*Pjesë kyçe e regjimeve të të burgosurve të dënuar është një program sistematik arsimi, duke përfshirë dhe aftësitë trajmuese, me objektivin e përmirësimit të nivelit të përgjithshëm të arsimit si dhe qëllimin e të pasurit të një jete të përgjegjshme dhe pa krimë.*”

20. Pastaj dispozitat e tjera i jepin një përparësi arsimimit të personave të rinj që janë të privuar nga liria, duke përcaktuar se: “*Vëmendje e veçantë i kushtohet arsimimit të të burgosurve në moshë të re ...*” (28.4). Ndërsa një dispozitë tjetër e sistemuar në pjesën për të drejtat e të miturve që qëndrojnë në institucionet korrektuese, arsimimin e tyre e definon si të drejtë që detyrimisht duhet të mundësohet, ku parashihet se: “*Çdo i burgosur që është i mitur dhe është subjekt i arsimit të detyrueshëm ka qasje në arsim*”.

21. Gjithashtu edhe rekomandimi nr. R(89) 12 për arsimin në burg, i miratuar nga Komiteti i Ministrave të KE-së, në vitin 1989, të drejtën në arsim e përcakton si themelore dhe si një nga mënyrat kryesore që lehtësojnë ri-integrimin në shoqëri të personave të dënuar.

22. Në lidhje me zbatimin e së drejtës në arsimim për personat që janë në vuajtje të dënimit, Avokati i Popullit në mënyrë të veçantë tërheq vërejtjen në lidhje me standartet e përcaktuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe protokollet e saj, si dhe vendimet e GJEDNJ-së. Në këtë drejtim, rëndësi të posaçme ka Protokolli nr.1 i KEDNJ-së, përkatësisht neni 2 i tij, ku përcaktohet se: “*Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.*” Si e tillë, e drejta për arsimim e garantuar me këtë dispozitë vlen edhe për personat e privuar nga liria.

23. Mbi këtë bazë edhe GJEDNJ-ja ka konstatuar se të burgosurit e ndaluar ligjërisht vazhdojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Konventa, me përjashtim të së drejtës për liri. Kështu ata kanë të drejtën e arsimimit të garantuar me nenin 2 të Protokollit nr. 1. Refuzimi për të regjistruar një të burgosur në një shkollë të burgjeve përbën shkelje të kësaj dispozite (*Velyo Velev kundër Bullgarisë, 27 maj 2014*). Sigurisht, e drejta për arsimim nuk nënkupton detyrimin e shtetit që të organizohen orë mësimi *ad-hoc* vetëm për shkak të kërkësave individuale, dhe pamundësia e plotësimit të këtyre kërkësave nuk përbën shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ (*Epistatu kundër Rumanisë, 24 shtator 2013*).

24. Nga kjo që u tha me lartë, del se standartet ndërkombëtare përcaktojnë detyrimin e institucioneve të Republikës së Kosovës që të garantojnë të drejtën për arsimim, si një e drejtë themelore edhe për personat në vuajtje të dënimit. Për më tepër, Avokati i Popullit rikujton se një obligim i tillë është i paraparë edhe në legjislacionin e brendshëm.

### **Legjislacioni i Republikës së Kosovës**

25. E drejta për arsimim, si e drejtë themelore e njeriut, përcaktohet edhe në legjislacionin e Republikës së Kosovës. Në përputhje me frymën dhe tekstin e akteve ndërkombëtare të përmendura me lartë, edhe në legjislacionin e brendshëm, e drejta për arsimim garantonohet

edhe për personat e privuar nga liria.

26. Fillimisht e drejta për arsimim, për shkak të rëndësisë që ka, përcaktohet në Kushtetutë, ku në nenin 47, paragrafi 1 parashihet se: 1. “*Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë....*”; dhe paragrafi 2 i po të njëjtët nen: “*Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.*”

27. Në pajtim me standarde KEDNJ-së në lidhje me të drejtën për arsimim dhe vendimet e GJEDNJ-së që u cituan me lartë, kjo e drejtë e paraparë me Kushtetutë nuk kufizohet as për personat që sipas ligjit janë privuar nga liria. Avokati i Popullit thekson se ky standard aq me tepër vlen për të rinjtë, përkatësisht të miturit në vuajtje të dënimit. Ky standard i respektimit të të drejtave të njeriut dhe moskufizimit të tyre edhe në raste e privimit nga liria, gjen mbështetje edhe në nenin 14 të KEDNJ-së, ku parashihet se : “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjeter, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjeter*”.

28. Andaj, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se edhe vendimet e institucioneve të Republikës së Kosovës, në veçanti nga MASHT-i, duhet të jenë në interesin me të mirë të personave të mitur, edhe kur bëhet fjalë për organizimin e procesit mësimor në QKL. Ky parim përcaktohet edhe në Kushtetutë, gjegjësisht nenin 50, paragrafi 4, ku thuhet se: “*Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.*” Gjithashtu, i njëjti përcaktim parashihet edhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, ku në nenin 3, paragrafi 1 thuhet se: “*Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institacione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legislative, interesit më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.*”

29. Për më tepër, e drejta në arsimim për personat e privuar nga liria, sidomos për të miturit që qëndrojnë në qendrat korrektese, siç është QKL-ja, garantohet edhe me disa nga ligjet e tjera që rregullojnë këtë të drejtë.

30. Kështu, në Ligjin për Arsimin Parauniversitar,<sup>3</sup> në nenin 5, paragrafi 15, për këtë qëllim përcaktohen detyrat e MASHT-it, si në vijim: “*Ministria në bashkëpunim me ministritë relevante, ndërmerr masa të veçanta për arsimin e individëve në burgje ose në institucionet për shkelësit e mitur të ligjit, si dhe për ata të myllur në institacione psikiatrike, ose për ata që i nënshtronhen hospitalizimit afatgjatë, janë në përkujdesje sociale në strehimore dhe për ata që janë liruar nga institucionet ose nga spitalet dhe vazhdojnë procesin arsimor.*” Ndërsa në paragrafin 16 të po të njëjtët nen, parashihet se: “*Ministria nxjerr akte nënligjore në çdo fushë të përgjegjësive të saj në bazë të këtij ligji ose cilitdo ligj tjetër në fuqi.*” Ky përcaktim

<sup>3</sup> Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 29 gusht 2011.

shpreh detyrimin ligjor që ka MASHT-ti për të nxjerrë akte nënligjore edhe në lidhje me përcaktimin e kushteve dhe kritereve që lidhen me organizimin e procesit mësimor në QKL.

31. Kodi i Drejtësisë për të Mitur (KDM)<sup>4</sup> në nenin 119 përcakton se: “*Nëse nuk ka orë mësimore për lëndë të caktuara ose nuk ka nivel arsimor në institucionin edukativ korrektues, i mituri lejohet të vijoje mësimin jashtë institucionit edukativo korrektues, nëse vijimi i tillë i mësimit nuk është i dëmshëm për ekzekutimin e masës edukative dhe vendimi arsyetohet me përparimet e mëparshme të të miturit në shkollim.*” Kjo dispozitë ndërton bazën që në rastet kur procesi arsimor nuk mund të zhvillohet në qendrën korrektuese, të miturit të vijojnë mësimin në shkollat jashtë. Avokati i Popullit këtë alternativë e konsideron të nevojshme të zbatohet edhe për të miturit që ndodhen në QKL dhe të dënuarit tjerë, kur procesi mësimor nuk arrihet të organizohet me kohë dhe në mënyrë cilësore brenda qendrës korrektuese.

32. Më tej, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, në nenin 84, paragrafi 1, përcakton se: “*Përmes programeve të veçanta, drejtori i institucionit korrektues i mundëson personit të dënuar vijimin e shkollimit fillor, të mesëm, universitar, apo ndonjë shkollim tjeter. Shpenzimet e shkollimit të tillë mbulohen nga personi i dënuar*”.

33. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), në nenin 83, paragrafi 7, përcaktohet gjithashtu se: “*Me akt nënligjor, të cilin e nxjerrë Ministri për Arsim me pëlqimin e Ministrit të Drejtësisë rrugullohet arsimimi i personave të dënuar.*” Kurse në nenin 86 të LESP-së përcaktohet se në: “*Dokumentin e lëshuar pas përfundimit të aftësimit profesional, ose kurseve arsimore nuk shënohet se kurset janë kryer gjatë qëndrimit të personit të dënuar në institucionin korrektues*”. Kjo për shkak të respektimit të parimit se diplomat dhe certifikatat për arsimim në qendrat korrektuese nuk duhet të dallojnë nga ato që fitohen në shkollat jashtë.

34. Sipas drejtorisë së QKL-së, në mungesë të aktit nënligjor, i cili precizon mënyrën se si do të realizohej kjo e drejtë, ata nuk kanë qenë në gjendje të sigurojnë mundësinë që të dënuarit të gëzojnë të drejtën për arsimim të lartë.

35. Natyrisht, personat e dënuar për ta gëzuar këtë të drejtë, qendrat korrektuese mund të përballen me probleme të sigurisë, të cilat kërkojnë aranzhime dhe vlerësimë të hollësishme nga Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe organet e qendrës korrektuese, ku i dënuari vuan dënimin.

36. Avokati i Popullit vlerëson se është obligim i drejtorisë së qendrës së caktuar korrektuese dhe SHKK-së që, para se t’ia japid një të drejtë të tillë një të dënuari, të bëjnë vlerësim të përgjithshëm të sigurisë, risocializimit të deritanishëm të të dënuarit, sjelljes së tij ndaj të tjerëve, si dhe nëse i dënuari në fjalë ka rënë ndesh me ligjin dhe rendin shtëpiak, e që si pasojë i janë shqiptuar masa ndëshkuuese të parapara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Rendin Shtëpiak.

37. Mbi bazën e një vlerësimi të tillë, qendra e caktuar korrektuese dhe SHKK-ja duhet të kërkojnë modalitetet më të përshtatshme për t’ua mundësuar të dënuarve të realizojnë të

<sup>4</sup> KODI Nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të mitur është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 10 korrik 2010.

drejtën e tyre për arsimim universitar, siç përcaktohet në nenin 84, paragrafi 1 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

### Konstatimet kryesore të Avokatit të Popullit

38. Në këtë raport është trajtuar një nga të drejtat themelore të njeriut, e drejta në arsimim, nga aspekti i gjëzimit të kësaj të drejte nga personat e privuar nga liria. Më konkretisht, raporti është fokusuar në organizimin e arsimit të lartë për personat në vuajtje të dënitit.

39. Nga analiza e së drejtës në arsimim në raport me aktet ndërkombëtare (në veçanti me KEDNJ-në dhe standardin e ndërtuar nga GJEDNJ-ja), Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit konstaton se kjo e drejtë garantohet edhe për personat e privuar nga liria. Aq më tepër, mundësimi i kësaj të drejte është obligim kushtetues dhe ligjor për institucionet e Republikës së Kosovës, kur bëhet fjalë për personat e mitur që janë të privuar nga liria, siç është rasti me të miturit që qëndrojnë në QKL.


40. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton të drejtën e të dënuarit për arsimim universitar dhe obligon që të dënuarit t'ia mundësojë realizimin e kësaj të drejte.

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 18, paragrafit 1, nënparagafi 7 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon:

#### Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Ministrisë së Drejtësisë:

- Nxjerrjen e aktit nënligjor në pajtim me Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, i cili do të precizonte mënyrën e realizimit të së drejtës për arsimim universitar për personat e mitur dhe madhorë që janë në vuajtje të dënitit.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Cdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkeseve të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkësë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), mirësish ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

  
Me inderime,  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit